

VENDIM
Nr. 844, datë 28.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 366, DATË 20.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM DHE VENDOSJEN E SERVITUTIT TË PËRHERSHËM TË KALIMIT, PËR INTERES PUBLIK, MBI DISA PASURI TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I LINJËS SË TENSIONIT DHE FACILITETEVE TË TJERA, PJESË E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (PROJEKTI TAP) AG’, NË ZONAT FIER, KORÇË, DEVOLL, BERAT DHE SKRAPAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikave 7 e 8, pjesa e parë dhe e dytë, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik, ratifikuar me ligjin nr. 116/2013; dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 366, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në pikat 3 dhe 5, shifra “26 769 500.64 (njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind pikë gjashtëdhjetë e katër)”, zëvendësohet me “26 760 542.64 (njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e dy pikë gjashtëdhjetë e katër)”;

b) në nënndarjen e fundit të pikës 3, shifra “35 232 (tridhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy)”, zëvendësohet me “35 195 (tridhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë)”;

c) në tabelën A, bashkëlidhur vendimit, të dhënat për numrat rendorë 55, 163 e 164 dhe totali zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë vendore, përkatësisht, Korçë, Devoll, Berat, Skrapar e Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

	Pronari/përdoruesi			Z.K.	Nr. pas.	Lloji pas.	Çmimi i blerjes	Sip. m² për marrje në përdorim të përkohshëm 1 vit	Çmimi /m²	Vlera lekë	Sip.m² servitut	Çmimi /m²	Vlera lekë	Sip. m² shpronësim	Çmimi /m²	Vlera lekë	Vlera totale e kulturave	Objekte vlera, lekë	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri																		
55	Dervish		Ramaj	8505	380/2	Ullishte		380	105.50	40090	82	211.00	17,302.00				22,981.89		80,373.89	K-34-112-(208-C)	ZVRPP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim
163	Dritan		Maka	2944	19/80			66	145.00	9570	227	290.00	65,830.00				34,690.70		110,090.70		Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Vezire		Maka																		
164	Llazi	Tomo	Golemi	2732	36/20			3307		684549	695	414.00	287,730.00						972,279.00		Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI								33,638		2,424,644.64	30,597		10,342,259.5	2,114		872,465	5,391,449.04	768,210.06	19,799,028.23		